

# sabiha-kasimati

SECTION

Historical figures

PERIOD

1937 - 1991

# Media 1

MEDIA ITEMS #1

*K. Cer*  
*Be Bures me*  
*Arif Ahmeti A. Shaban Pashaj*  
*102*  
*24-VI-1991*  
*15.6.1991*

KUVËNDIT POPULLOR  
 PRESIDENTIT RAMIZ ALIA  
 MINISTRIE SE DREJTËSISE  
 GJYKES SE LARTË  
 PROKURORISE SE PËRGJITHSHEME  
 MINISTRIE SE PUNËVE TE BRENDEMEDE  
 FORUMIT PER MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE NJERZIT

Ne, pjesetaret e familjever qe kemi te pushkatuar njerzait tane pa gjyq ne periudhen shkurt-mars 1951 paraqesin kerkesen si me poshte:

Dihet se ne periudhen shkurt-mars 1951 ne Tirane, ne kushte et e terrorit, u arrestuan dhe ne mungese te procesit gjyqesor, u pushkatuan prinderit tane. Eshhte rreprezalja ne e eger e populise civile te pafajshme, e organizuar nga forcat e erreta kriminale ne pushtet, veprim kerjtesisht i pajustifikueshem, mbasi ishte viti 1951 pra pas shtate vitesh cilrimi dhe konsolidimi te pushtetit Popullor.

Eshhte per tu theksuar qendrimi burroror i zoterinjve Manol Kononi dhe Teodor Heba te cilët protestuan ndaj masakres qe u be ne mungesa te nje procesi gjyqesor, dhe dhane dorheqjen nga detyrat e tyre.

Jane te njohura perspektivat politike te pjesetareve te familjeve, si: burgosje, interrim, diskriminime dhe shprensime qe si pas ligjit enverist vazhduan deri ne brezite e treta bile dhe te ka terta. Kane kaluar dyzet vjet dhe ne ende sot, nuk e dime dhe nuk e njohim arsyen dhe crahmat e pushkatimit, numrin e sakte te viktimave (dikush thote 72, nesehta ?) dhe vendin (gropen e perbashtket) ku jane hedhur kufomat.

Realiteti i ri qe po jetojme qendrimi kritik dhe i prere i te gjitha forcave politike ndaj luftes se klasave dhe gabimeve te se kaluares deshira e sincere e te gjithëve per pajtim kombetar, pace sociale e progres demokretik na jep te drejten dhe ne qe te bejme kerkese per kete ceshtje:

1. Ne driten e te vertetes te benet rehabilitimi politik zyrtar i v iktimave te pushkatuar.
2. Te jepet urdhor qe ne rruge legale ligjore, te zhvillohen hetimet per te zbuluar gropen e perbashtket ku treten eshtrrat e prinderve tane te ppharuar.

Zgjidhjen e dy kerkesave te mesiperme e konsiderojme detyre morale dhe ceshtje nderi per gjithe kombin shqiptetar.

MEDIA ITEMS #2

Le te sherbeja kjo zgjidhje mbare kombit brenda dhe jashte Atdheut se demokratizimi ne Shqiperi eshte nje realiteti kohes dhe i pakthyeshem dhe se forcat e erreta te neteve te zera te shkurtit te pergjakur nuk do ti bien ne qafe kurre ne popullit te shumevuajtur shqiptetar.

Me nderime  
 Familjaret e viktimave

*Filip Gjeter Gurozari* *F. G.*  
*Viktor Refik Kaminati* *V. K.*  
*Reardhyl Shumera* *R. S.*  
*Baronj Le Nisana* *Baronj*  
*Sadiq Kocelo* *S. K.*  
*Lumi Memet Bicari* *L. B.*  
*Antonjete Ankaq Selbyze* *Antonjete*  
*Jola Gjoni Tomoli* *J. T.*  
*Djalshana Bejri Shkuri* *D. S.*  
*Demal Rexhep Droni* *D. R.*  
*Meclihor Gajfura Japari* *M. J.*  
*Albanjze Muzaj Tomaj* *A. T.*  
*Sadiq Kufteqez* *S. K.*  
*Demir Gulluqi* *D. G.* (Fadil Dredhaci)  
*Hysen Selfo* *H. S.*  
*Perim Urdani* *P. U.*

#### INFORMATION


No additional information is available for this media.

#### TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

## Media 2

## MEDIA ITEMS #1



## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

# Media 3

## MEDIA ITEMS #1

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
 GJYKATA E LARTË  
 Nr. \_\_\_\_\_ Tiranë, më \_\_\_\_\_ 1991

K E R K E S E  
 PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISE  
K U N D E R  
 Vendimit Nr.64, datë 27.2.1951, të gjykatës së Lartë  
 Ushtareke.

P E R P A R A  
 PLENUMIT TË GJYKATËS SË LARTË  
T I R A N Ë

Me vendimin Nr.64, datë 27.2.1951, të gjykatës së Lartë Ushtareke, është vendosur deklarimi fajtor i të gjykuarve : Tefik Shehu, Hekuran Troka, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Disdari, Ali Qorallia, Jonuz Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Skonomi, Zyhdë Herri, Niko Leco, Myftar Jegeni, Qemal Kacardho, Manush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selfo, Gjon Temali, Fjetrin Guraziu, Mehmet Shkupi dhe Sabina Kasimati, për fajë kundër popullit e shtetit, e në bazë të neneve 2 dhe 3 (pikat 7,8 e 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946, /dënuar me vdekje.

Ky vendim është i kundërligjshëm dhe nuk mbështetet në asnjë provë.

Me aktakusën datë 25.2.1951, të prokurorit ushtarak, të gjithë të gjykuarit janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë Ushtareke ndën akuzën për fajë kundër popullit e shtetit, të parashikuar nga Ligji Nr.372, datë 12.12.1946. Siç rezulton nga aktet e dosjes hetimore, asnjëri prej të gjykuarve nuk u është komunikuar ndonjë akuzë, ndërsa vetëm njëri prej tyre, i gjykuari Gjon Temali, është pyetur nga Sekcioni i Sigurimit të Shtetit (edhe në këtë rast nuk i është komunikuar ndonjë akuzë konkrete), por vetëm thuhet "mbi akuzën që i atribuohet". Ky procesverbal, që mban po datën 25.2.1951, nuk është nënshkruar as nga i akuzuari dhe as nga personat që e kanë marrë atë në pyetje. Asnjë provë tjetër nuk ka shoqëruar dosjen hetimore.

Gjykata ka filluar shqyrtimin e çështjes më 26.2.1951. Kjo seancë gjyqësore është zhvilluar pa pjesëmarrje të prokurorit dhe të avokatëve mbrojtës. Sikundër rezulton nga ky procesverbal, në seancë gjyqësore, janë dëgjuar vetëm të gjykuarit të cilët janë pyetur fare shkurt. Procesverballi jo vetëm që nuk është firmosur nga kryetari e sekretari i seancës, por as që është mbyllur. Fra nuk mund të thuhet as dhe përse vendimi mban datën 27.2.1951.

Në pjesën hyrëse të vendimit thuhet se çështja është shqyrtuar në  
 /..

## MEDIA ITEMS #2

- 2 -

basë të ligjit të ri për aktet terroriste, pa përmendur cili është ai akt dhe as kohën e daljes së tij. Në këtë rast duhet të jetë fjala për dekretin Nr.1223, datë 26.2.1951, që është miratuar po ditën e shqyrtimit të çështjes në gjykatë. Duke qenë çështja kështu, edhe në bazë të atij dekreti, shqyrtimi i çështjes në gjykatë, ka qenë i kundërligjshëm. Kjo për arsye se të gjitha veprimet hetimore janë kryer jo në bazë të ligjit, mbasi ato janë kryer pa dalë ligji i ri. Fra veprimet hetimore e gjyqësore i kanë paraprirë ligjit.

Dhe të gjitha këto veprime të kundërligjshme, mbyllen me një vendim, po të kundërligjshëm. Në vendim gjyqësor megjithëse akuzohen për organizim e pjesëmarrje në organizatë terroriste, nuk sillët asnjë provë dhe nuk bëhet asnjë analizë. Përkundrazi, edhe nga shpjegimet e të gjykuarve nuk del asnjë e dhënë që ata jo më të jenë organizuar apo biseduar midis tyre për organizatën terroriste, por as dhe të kenë njohje.

Dhe në fundi vendimi gjyqësor, nuk nënshkruhet rregullisht nga gjithë trupi gjyqësor, mbasi mungon firma e një anëtarit.

Të mara në tërësi këto shkelje të ligjit si dhe mungesa e plotë e një hetimi objektiv, e të jenë vendimin e gjykatës të kundërligjshëm.

P R A N D A J,  
 Në bazë të neneve 179 e vijues të K P Penale,  
K E R K O J :  
 Frishjen e vendimit penal Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtareke dhe pushimi i çështjes.

K R Y E T A R I  
 / Kleuth Koci /  
*Kleuth Koci*

#### INFORMATION


No additional information is available for this media.

#### TRANSCRIPT


No transcript is available for this media.

## Media 4

## MEDIA ITEMS #1



## MEDIA ITEMS #2



- 3 -

14. MYFTAR JEGREVI, lindur në Dibër të Madhe, banues në Tiranë, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

15. QEMAL KAGARUHO, i biri i Nuriut, i dtl.1902, lindur në Gjirokastrë e banues në Tiranë, shtresë e pasur, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

16. MANUSH PESHKËPIA, i biri i Tasimit dhe i Marrijes, lindur në Miorë e banues në Tiranë, shtresë e pasur, i dënuar më 1945 si kriminel lufte, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

17. ANDON DELHLYSA, i biri i Stefanit dhe i Liesë, i dtl. 1904, lindur në Prizren (Kosovë) e banues në Tiranë, teknik në shtetin, shtresë e pasur, i arrestuar më 20.2.1951.

18. REIS SHELCO, i biri i Xhevdetit dhe i Zakijes, i dtl. 1896, lindur në Gjirokastrë e banues në Tiranë, tregtar, shtresë e pasur, i arrestuar më 23.2.1951.

19. GJON TEMALI, i biri i Markut dhe i Marrijes, i dtl. 1904, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, farmacist, i arrestuar më 20.2.1951.

20. PJETERI CURAJU, i biri i Filipit dhe i Liesë, i dtl. 1902, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, nëpunës, shtresë e pasur, i arrestuar më 22.2.1951.

21. MESHUM SHKUPI, i biri i Aliut dhe i Elifes, i dtl. 1893, lindur në Shkup e banues në Tiranë, kaloriferist, i arrestuar më 20.2.1951.

22. SABIHAN KASIMATI, e bija e Abdurrahmanit dhe e Zerasë, e dtl.1916, lindur në Turqi e banues në Tiranë, nëpunës, e arrestuar më 20.2.1951.

**T E R M I N I M:**

Për faje kundër popullit dhe shtetit, parashikuar nga nenet 2 dhe 3 (pikat 7,8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946.

-----

Në vendimin Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtrake Tiranë, është vendosur deklarimi fajtorë i të gjithë të gjykuarve për krimin e kryer kundër popullit dhe shtetit dhe në bazë të neneve 2 dhe 3 (7,8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946, të gjithë janë dënuar me vdekje.

./..

- 4 -

Kundër vendimit të mësipërm ka bërë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kryetari i Gjykatës së Lartë, duke kërkuar prishjen e tij dhe pushimin e çështjes duke i deklaruar ata të pafajshëm për këto shkaqe:

- Vendimi i gjykatës nuk mbështetet në asnjë provë dhe është i kundërligjshëm.
- Nga materialet e kësaj dosjeje, rezultojnë se nuk janë zbatuar rregullat procedurale kryesore, si vendimi për fillim të çështjes penale, nuk u është komunikuar ndonjë akuzë, nuk janë pyetur dhe nuk kanë dhënë asnjë shpjegim në hetuesi (me përjashtim të të gjykuarit Gjon Temali), nuk u është komunikuar kopja e akt-akuzës etj.
- Edhe në seancë gjyqësore, të gjykuarit janë pyetur fare shkurt, nuk janë ballafaquar dhe nuk është administruar asnjë provë tjetër.
- Çështja është shqyrtuar në gjykatë më 26.2.1951, pra ditën që ka dalë Dekreti i Ri Nr.1223, datë 26.2.1951, "mbi hetimin e gjykimin e veprave terroriste". Duke qenë kështu, edhe në bazë të atij dekreti, shqyrtimi i çështjes në gjykatë ka qenë i kundërligjshëm për arsyen se të gjitha veprimet hetimore janë kryer pa dalë ligji i ri.
- Vendimi përfundimtar i gjykatës nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjyqësor, mbase mungon firma e njërit prej anëtarëve.

**PLENUMI I GJYKATËS SË LARTË,**

pesi dëgjoi relacionin e anëtarit Agim Shkupi, të vëndësprokurorin e Përgjithshëm, Spiro Peçi, që shfaq mendimin për pranimin e kërkesës si dhe pesi shqyrtoi çështjen në tërësi.

**V E R D E M:**

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e drejtë dhe dhjet pranuar në tërësi.

./..

Me akt-akuzën datë 25.2.1951, të prokurorit ushtarak të gjykuarit : Tefik Shehu, Hekuran Troka, Lluqa Rashkoviç, Haki Kodra, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Disedari, Ali Qorallia, Jonus Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Ekonomi, Zyhdë Herri, Niko Leco, Myftar Jegeni, Qemal Kacaruhë, Mamush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selto, Gjon Temali, Fjetrin Guraziu, Mehmet Shkupi dhe Sabiha Kasimati, janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë Ushtarake Tiranë ndërmjet akuzës për feje kundër popullit e shtetit, të parashikuara nga nenet 2 dhe 3 (pikat 7, 8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946.

Megjithatë bëhet fjalë për akuzë shumë të rënda, dosja hetimore nuk përmban asnjë provë. Jo vetëm që nuk janë pyetur të gjykuarit (me përjashtim të Gjon Temalit), por nuk është pyetur asnjë dëshmitar apo nuk është administruar ndonjë provë shkresëre që të fajsojnë të gjykuarit. Po ashtu, nuk ka vendim mbi fillimin e çështjes penale, vendim mbi marrjen si të përdhur dhe komunikim të akuzës dhe përfundimisht as akt-akuzë nuk u është dorëzuar apo bërë e njohur të përdhurve. Të gjitha këto përbëjnë shkelje të rënda të ligjit.

Gjykata, çështjen e ka shqyrtuar në seancë gjyqësore më 26.2.1951, pa pjesëmarrje të prokurorit dhe të avokatëve mbrojtës. Sikundër rezultoi nga procesverbali, në seancë gjyqësore janë dërguar vetëm të përdhurit të cilët janë pyetur fare shkurt. Megjithatë ata janë akuzuar për organizim e pjesëmarrje në një organizatë terroriste, gjykata nuk është ndalur fare për vërtetimin e kësaj akuzë. Përkundrazi, nga shpjegimet që kanë dhënë të gjykuarit, ka dalë se ata jo vetëm që nuk kanë krijuar apo organizuar ndonjë organizatë terroriste por për më tepër ata as që kanë qenë njohur apo të kanë patur ndonjë lidhje midis tyre. Në mungesë të hetimeve paraprake (hetuesisë), gjykatësi binte në detyrë që të paktën çështjen ta hetonte në mënyrë të plotë në seancë gjyqësore. Por dhe këtu detyrë gjykata nuk e ka realizuar. Kështu jo vetëm që nuk është administruar ndonjë provë tjetër, si pyetje dëshmitarësh, administrim provash të tjera të nevojshme, por as që janë bërë ballafaqime midis të gjykuarve. Pra mungesa e hetimit ka veshdruar dhe në gjykim. Dhe në fakt, edhe gjykata nuk ka patur se çfarë të hetonte, mbasi nuk ka patur asnjë fakt që të gjykuarit të kishin kryer ndonjë aktivitet armiqësor kundër popullit dhe shtetit.

./..

#### MEDIA ITEMS #6

Nga ana tjetër, në vendimin e gjykatës thuhet se çështja është shqyrtuar në bashkë të rregullave që parashikon Ligji i Ri "Mbi hetimin e gjykimin e veprave terroriste", pa përmendur se cili është ky ligj. Në këtë rast duhet të jetë fjala për Dekretin Nr.1223, datë 26.2.1951, pra që është nxjerrë pa ditën e shqyrtimit të çështjes në gjykatë.

Duke qenë kështu, edhe gjykata nuk e ka patur parasysh në shqyrtimin e çështjes, mbasi po atë ditë që ka dalë ai dekret është zhvilluar dhe seanca gjyqësore.

Dhe së fundi procesverbali i seancës gjyqësore jo vetëm që nuk është nënshkruar nga kryetari i seancës dhe sekretari, por as është mbyllur. Po ashtu dhe në vendimin përfundimtar të gjykatës, mungon firma e një anëtarë të trupit gjyqësor.

Të marea në tërësi këto shkelje të ligjit si dhe mungesa e plotë e fakteve dhe e provave, që bëjnë vendimin të kundërligjshëm. Për rrjedhojë, përderisa nuk vërtetohet që të gjykuarit të kenë kryer veprën penale për të cilën janë deklaruar fajtorë dhe dënuar, çështja penale në ngafim të tyre duhet të pushohet dhe ata të deklarohen të pafajshëm.

PËR KËTO arsye,


Fleminë e Gjykatës së Lartë, në bashkë të neneve 182/2 dhe 185/3 të K P Penale.

V E N D O S I :

Friahjen e vendimit Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtarake Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngafim të të gjykuarve : Tefik Shehu, Hekuran Troka, Lluqa Rashkoviç, Haki Kodra, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Disedari, Ali Qorallia, Jonus Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Ekonomi, Zyhdë Herri, Niko Leco, Myftar Jegeni, Qemal Kacaruhë, Mamush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selto, Gjon Temali, Fjetrin Guraziu, Mehmet Shkupi dhe Sabiha Kasimati.

./..

#### MEDIA ITEMS #7



INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

## Media 5

MEDIA ITEMS #1



## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

## Media 6

MEDIA ITEMS #1



INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.